



Asociacioni i Komunave të Kosovës

Nga:	Azem Guri– Kryesues i Kolegjiutit për Arsim dhe Kulturë
Për:	z. Ramë Buja, Ministër për Arsim Shkence dhe Teknologji
Përmes:	z. Xhavit Dakaj – Sekretar i përgjithshëm ne MASHT
Data:	11 .10. 2011
Subjekti:	Konkluzionet e takimit te Kryesisë së Kolegjiutit për Arsim dhe Kulture me Ministrin e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë



Prishtinë, 11 tetor 2011

Përmbledhje

Nga takimi i fundit i Kolegjiumit për Arsim dhe Kulturë i mbajtur me 14.9.2011 në Prishtinë, doli me rekomandim për organizimin e një takimi me Ministrin e MASHT-it për diskutim të çështjeve me rëndësi që kanë të bëjnë me funksionimin dhe përmirësimin e sistemit arsimor komunal.

Kryesia e Kolegjiumit të drejtorëve të Arsimit dhe Kulturës në bazë të kësaj kërkesë mbajti takim me Ministrin për diskutimin e të gjitha problemeve, sfidave, vështirësive të cilët hasin Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe gjetjen e masave konkrete në tejkalimin e këtyre problemeve, gjatë këtij takimi ishin prezent Ministri i MASHT-it z. Ramë Buja dhe sekretari i përgjithshëm z. Xhavit Dakaj. Kryesia e Kolegjiumit të drejtorëve paraqiti si pikë të veçantë diskutimin për provimin e maturës dhe po ashtu u ra dakord që në takimet e Kolegjiumit vazhdimisht të marrë pjesë një përfaqësues i MASHT-it i cili do të jap sqarime dhe përgjigje për çështjet relevante me të cilat përballet Kolegjiumi dhe i cili do të njoftoj Ministrinë për kërkesat dhe rekomandimet e dala të Kolegjiumit.

Nga ky takim i kolegjiumit dalin këto:

R e k o m a n d i m e

- Nxjerrja e Udhëzimit Administrativ mbi ruajtjen e vendit të punës të drejtorit të shkollës
- Nxjerrja e UA që shkollat fillore dhe të mesme të ulëta të emërtohen "Shkolla nëntë vjeçare" apo pesë vjeçare (nëse është e ndarë) për shkak të titullit të gjatë.
- Harmonizimi i Kontratave të punës për mësimdhënësit (**e rregulluar**)
- Zbatimi i UA për Vazhdimin e kontratës së punës për mësimdhënësit punëtor pas 65 viteve brenda vitit mësimor. (ky Udhëzim ka qenë, por nuk është harmonizuar me ligjin pasi mësimdhënësit të cilët kanë punuar deri në fund të viti shkollor nuk janë kompensuar)
- Nxjerrja e UA që lejon përsëritjen e klasës edhe të nxënësve deri në klasën e VI-të, me qëllim që mos humbet motivi i punës së nxënësve sepse atë që po e humbin nxënësit deri në këtë moshë nuk mund të riparohen lehtë pas klasës së VI-të.
- Nxjerrja e UA për verifikimin e aftësive psiko-fizike të mësimdhënësve, dhe atyre me sëmundje kronike për pensionim të parakohshëm.
- Nxjerrja e UA mbi Normativin për ngarkesën e mësimdhënësve dhe numrin e orëve për mësim të rregullt deri në 24 orë si normë të plotë. (me formulë financimi)
- Nxjerrja e UA për futjen e orës së kujdestarisë në fond të orëve, me qëllim të evitimit të disa dukurive negative dhe përmirësimin e suksesit të nxënësve.

